



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e75-të, të mbajtur më 14.10.2022, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Denoncimi me numër 12-7089/1 i datës 17.12.2021, HIDHET POSHT.  
KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.  
denoncimi të dërgohet për veprim kompetent në Drejtorinë e Policisë Financiare të RMV-së.

Lënda me numër 12-7089 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-7089/1 datë 17.12.2021 është ngritur në bazë te denoncimit të paraqitur nga ///, si dhe në bazë të kontrollit të pasqyrave financiare të ///, për zgjedhjet lokale në ///. Në raportin e auditimit, vërehet se studenti i përmendur më parë nuk ka paraqitur raporte financiare apo dokumentacion në zgjedhjet lokale/// në /// për të hetuar ligjshmërinë e financimit të fushatës së tij zgjedhore. Në shtojcë të denoncimit është dorëzuar version i skanuar i raportit të auditimit në CD .

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe raportit të auditimit, KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk ka elemente për veprim kompetent. Autoriteti kompetent që mund të shqyrtojë ligjshmërinë e financimit të fushatës zgjedhore nga pikëpamja e një krimi të mundshëm të "pastrimit të parave" është Drejtoria e Policisë Financiare të RMV-së, për të cilën KSHPK-ja e vlerësoi të nevojshme të përcjellë denoncimin me raportin e auditimit pranë këtij autoriteti me veprim kompetent.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: N.B.

КОМИСИОН ШТЕТЁРОРЁ  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
КРЈЕТАРЕ,  
Biljana Ivanovska

